

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet - Grabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni në Firenze, ja çfarë morën hajdutët.... Nipi: Kur e njoftova më pyeti për
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917636/grabitet-apartamenti-i-kardinalit-ernest-simoni-ne-firence-ja-cfare-moren-hajdutet-hellip-nipi-kur-e-njoftova-me-pyeti-per/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:17:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:00:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d5ec961e49c552e31dff55ad55f229ce84f90801a991ce6028ec1f6039778ed
TEKSTI	7e44b17d6beab054a10bab891e7c7a70d6ba0c243a0a04f085f28528b839937b
PAMJA	24ad92f2f20e82d74365618f1bf20ceadd0241c59114f61165640cfa9471d4cb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	23a66c0713192ffee7c31a676306c9dee4dd36ed4d085a63c20b02da4673b544
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/23a66c0713192ffee7c31a676306c9dee4dd36ed4d085a63c20b02da4673b544>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



PROF. MYQEREM TAJ
Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!



SONILA MEÇO
"Në emër të popullit të Kosovës", prokura e një kurthi



më të lexuarat

Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve

Bllokimi i pagave të gjyqtarëve/ SPAK merr në pyetje përgjegjësen e Thesarit, ja çfarë dimë deri tani

Shpërthim në Shijak! Zbulohet emri i pronarit të banesës ku u vendos eksplozivi

Arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë

Shortohet seanca për Ergys Agasin e Uliat Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë

I dhunojnë dhe arrestojnë/ Policia prangos 12 protestues se thirrën: Rama jepe dorëheqjen

Grabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni në Firence, ja çfarë morën hajdutët.... Nipi: Kur e njoftova më pyeti për

17:00, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Një grabitje e pazakontë ka ndodhur në një prej zonave më të frekuentuara dhe të mbikëqyruara të Firences, në apartamentin e Curias në Piazza Duomo, ku jeton kardinali shqiptar Ernest Simoni, 97 vjeç, së bashku me nipin e tij.

Autorët e grabitjes kishin mbërritur të pajisur me mjetet e nevojshme për të çarë murin dhe për të hapur derën e blinduar të banesës dhe për t'u arratisur me një shumë të konsiderueshme parash dhe sendesh me vlerë.

Sipas mediave italiane, dëmi dhe vjedhja kapin vlerën e rreth 30 mijë eurove. Në mesin e sendeve të marra kishte para cash, objekte ari, disa bizhuteri, medalje dhe një vulë ari.

Në momentin kur ndodhi grabitja, kardinali Simoni nuk ndodhej në Firence. Ai është aktualisht në Londër, ku ka zhvilluar një takim me mbretin Charles.

Sipas mediave italiane, as nipi i tij, Tonin, dhe as bashkëshortja e tij nuk ishin në banesë. Ata ishin larguar rreth orës 13:00 dhe u kthyen rreth orës 23:00, kur zbuluan se shtëpia ishte grabitur.

Kur u kthyen në banesë, familjarët gjetën një pjesë të murit të dëmtuar rëndë. Hajdutët kishin përdorur dy daltë, të cilat më pas i kishin lënë në shkallët e pallatit. Ata kishin arritur të hapnin derën e blinduar dhe më pas kishin kontrolluar dollapët, valixhet dhe kasafortat, duke lënë banesën tërësisht rrëmujë.

Pavarësisht kohës që duket se është dashur për të çarë murin dhe për të hapur derën e blinduar, askush nuk kishte vënë re asgjë. As fqinji në katin poshtë nuk kishte dëgjuar apo konstatuar diçka të dyshimtë.

"Jemi të tronditur nga ajo që ka ndodhur. Ndihehim të sigurt. Mund të prisnim gjithçka. përveç faktit që hajdutët të arrinin të bënin një shkatërrim të tillë në

Piazza Duomo, ndoshta edhe në mes të ditës. Ajo që ka ndodhur është një turp për qytetin", tha Tonin Simoni.

Karabinierët ndërhyjnë menjëherë pas denoncimit, ndërsa ekspertët kriminalistikë kryen këqyrjen e banesës në kërkim të gjurmëve që mund të çojnë te autorët.

Zona e Piazza Duomo është e pajisur me disa kamera sigurie dhe hetuesit kanë nisur të analizojnë pamjet e regjistruara.

"Piazza Duomo është zona më e mbikëqyrur e Firences. Është e pabesueshme që kanë arritur të bëjnë diçka të tillë pikërisht këtu", u shpreh nipi i kardinalit. "S'kemi fjetur. Kaluam natën duke sistemuar gjithçka dhe më pas qëndrova në një karrige, pasi dera nuk mund të mbyllej", tregoi ai.

Sipas tij, grabitja mund të mos ketë qenë rastësore. "Me siguri, kush e ka bërë një gjë të tillë nuk ka goditur rastësisht. Na kanë mbajtur nën vëzhgim dhe e dinin që nuk ishim në shtëpi", tha Tonin.



Mes sendeve të vjedhura ka edhe objekte me vlerë të vogël, përfshirë një kablo të vjetër të një PlayStation-i, që i përkiste periudhës kur fëmijët e Toninit ishin të vegjël.

Por një prej sendeve që ka ngritur më shumë pikëpyetje është karta e qëndrimit të kardinalit Ernest Simoni, e cila mbahej në një sirtar.

"Vjedhja e këtij dokumenti është mjaft e çuditshme. Përveçse nëse kanë ndërmend ta falsifikojnë", tha nipi i kardinalit.

Në total, mes parave cash dhe sendeve të arit, disa bizhuteri të bashkëshortes së Toninit, medaljeve dhe një vule ari, vlera e grabitjes llogaritet në rreth 30 mijë euro.

Reagimi i parë i kardinalit Ernest Simoni nuk ishte për paratë apo sendet me vlerë, por për statujat fetare që mbahen në dhomën e tij, e cila i ngjan një kapelë të vogël.

"Pyetja e tij e parë ishte nëse hajdutët kishin dëmtuar statujat fetare që ruhen në dhomën e tij. Më pyeti: 'Statujën e Zonjës së Medjugorjes e kanë lënë? Po statujën e Padre Pios?'", tregoi Tonin.

Kur nipi e siguroi se të gjitha statujat ishin në vend dhe nuk ishin dëmtuar, kardinali u përgjigj: "Atëherë, s'ka ndonjë problem të madh."

© SYRI.net

Lexo edhe:



Emri i një pensionisti u përdor për ndryshimin e 45 identiteteve. Pezullohen 2 zyrtarë, Indrit Aliu shpallet në kërkim



Pagat e magistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...



Zjarr në sektorin Rinia në Durrës

Laboratori i heroinës në Has dhe dosja '339', arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli! Fitimet i investoi në dy lokale në Shijak

Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtarë i trupit gjykues

Arratisje si në filma/ Forcat speciale spanjolle arrestojnë shqiptarin me ... mbi 80 precedentë penalë

TË NGJASHME



SYRI TV - Zhduku shishet e verës miliona euro/ Burg kushëririt të Ergys Agasit, dosja i kalon SPAK



Makina përplaslet me barrierat në aksin Elbasan-Peqin, plagoset një grua dhe një fëmijë



SYRI TV/ Plagosja e kolegut, avokatët në Durrës bojkotojnë seancat për rreth 2 orë



25-vjeçari rrëshqet aksidentalisht në lokal, niset me helikopter drejt Traumës



Kultivonte bimë narkotike në mes të pyllit, pranga 37-vjeçarit në Mirditë



EMRAT/ Arrestohen në Itali dy shqiptarë, ja për çfarë akuzohen



Shortohet seanca për Ergys Agasin e Ulian Shpataarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë

[LAJME](#) [POLITIKË](#) [KRONIKË](#) [EKONOMI](#) [KOSOVA](#) [BOTË](#) [KULTURË](#) [SHKENCË](#) [SPORT](#) [JETE-STIL](#) [TRASHËGIMI](#) [MIEDIS](#) [ARKIVA](#)



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.